



KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE

Nr. 7300/ Prot.

Lutemi ta referoni në rast pergjigjeje

Tiranë, më 17/08/2016

## FTESË PËR NEGOCIATA

### I.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri KESH sh.a (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare)  
Adresa Blloku "Vasil SHANTO", P.O. Box 259/1 Tiranë  
Tel/Fax+355 04 225 8977  
E-mail mail@kesh.al  
Adresa e Internetit www.kesh.al

### I.2 Emri dhe adresa e personit përgjegjës:

Emri Ilir Saqellari  
Adresa Blloku "Vasil SHANTO", P.O. Box 259/1 Tiranë  
Tel/Fax 0697070248  
E-mail saqellarii@kesh.al

Autoriteti Kontraktor KESH sh.a do të zhvillojë procedurën e **botimit në shtypin e shkruar të Ftesës për Ofertë për procedurën Tender i hapur "Shërbime Konsulente për Konsulentin e Implementimit për Rehabilitimin e Portave të Shkarkimit në HEC Vau i Dejës"**, me fond limit me vlerë 100,000 (njëqind mijë) lekë, pa TVSH.

**Nevoja për kryerjen e botimit:** Në referencë të kërkesës së njësisë PMU-DSP, Nr. 7300, datë 15.08.2016, është kërkuar realizimi i botimit të njoftimit, Ftesë për Ofertë.

**Shpeshhtësia e shfaqjes së reklamës:** 2 (dy) ditë, datë 19-20 gusht 2016

**Përmbajtja:** Shpallje në gjuhën Shqipe dhe Angleze, në ½ faqe të një gazete, pa ngjyra;

**Fondi limit i percaktuar:** 100,000 (njëqind mijë) Lek pa TVSH

**Afati i fundit** për paraqitjen e konfirmimeve nga organet e masmedias/ agjencitë e specializuara është deri më dt. 18.08.2016, në orën 12:00, pranë zyrave qendrore të Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare sh.a.

**Konfirmimet:** Konfirmimet duhet të vinë të gjitha në një ditë të vetme, të mbyllura në zarf, të shënuara me adresën dhe emërtimin e subjektit, në rast te kundert ata do të refuzohen dhe do të kthehen të pahapura. Konfirmimet duhet të jenë në gjuhën Shqipe.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë autoritetit tonë kontraktor konfirmimet tuaja.

### Dokumentacioni ligjor qe duhet paraqitur si kriter kualifikues:

1. Ekstrakti i QKR, që vërteton se operatori ushtron ketë aktivitet ekonomik tregtar.
2. Dokument qe vërteton se operatori ekonomik ka shlyer detyrimet fiskale për vitin 2015.

Dokumentacioni te jete original ose kopje e noterizuar i leshuar brenda 3 muajve te fundit (vertetimet e QKR dhe administratës tatimore)

**Përzgjedhja dhe vlerësimi i ofertave:**

Përzgjedhja e ofertave sipas pikës nr. 7 dhe 12 te VKM nr. 1195 date 05.08.2008

• **Vlerësohet me 50 pike faktori i impaktit:**

Faktori i impaktit është masa në të cilën artikulli/njoftimi do të aksesohet nga personat që mund të shfaqin interes, për shkak të tirazhit dhe informacionit të përcjelle nga periodiku.

• **Vlerësohet me 50 pikë oferta më e ulët** ekonomike e operatorit.

Oferta ekonomike do të jetë e paraqitur në Lek paTVSH.

Ofertuesit kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e hapjes së ofertave perfaqesuesit apo personat me autorizim.

Ofertat duhet të jenë të mbyllura në zarf, të vulosura dhe do të dorëzohen nga përfaqësuesit e shoqërive pranë KESH sh.a. ose para komisionit në datën dhe orën e përcaktuar.

Komisioni nuk do të pranojë asnjë ofertë e cila do të dorëzohet tej afatit të përcaktuar dhe jo në përputhje me kërkesat e mësipërme.

**Jemi në pritje të konfirmimit tuaj për negociim.**

**KRYETARI I KOMISIONIT**

**Taulant HOXHA**